



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 4, datë 11.01.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E APELIT TIRANË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Olsi Xhavella (relator), si dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Arta Duka dhe Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Person nën hetim: {...}; Objekti: “Vleftësim si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”.

**GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Asim Vokshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}; personi i tretë: {...}; Objekti: “Shfuqizimi i vendimit nr. 61, datë 23.12.2020 i KED-së, për përfundimin e kandidimit të kandidatës {...}, në vendin vakant për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme shpallur nga Presidentii i Republikës në datën 22.11.2019. Detyrimin e KED-së të marrë sërish në vlerësim kandidaturën e paditëses Zhaklina Peto, duke i bërë vlerësimin e kritereve profesionale dhe pikëzimin në përputhje me ligjin”.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**